



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 37/2011
Prishtinë, më 01.11.2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Sala Berisha - Shala, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka dhe Berat Buzhala.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Brikena Hoxha - konsulente.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18. 10. 2011;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
4. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18. 10. 2011

Procesverbali i mbledhjes së datës 18. 10. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari – Tha se edhe për këtë Projektligji është mirë të vazhdohet me procedurat sikur me projektligjet e tjera. Propozoi të formohet një grupi pune prej tre anëtarëve për ta shqyrtuar dhe për ta amendamentuar Projektligjin.

Myzejene Selmani – Është mirë që Qeveria para se t'i sjellë projektligjet për plotësim-ndryshim në Kuvend të shikojë mos është në fuqi ndonjë ligj që e rregullon këtë fushë. Në qoftë se duhet të amendamentohet mbi 40% e projektligjit, atëherë ai t'i kthehet Qeverisë.

Kryetari – Theksoi se derisa nuk fillon grupi i punës me shqyrtimin e projektligjit në fjalë, nuk duhet të paragjykohet sa duhet të amendamentohet. Prandaj kërkoi që grupit të punës t'i bashkohen dhe organizata që e mbështesin me projekte punën e Komisionit, që të ndihmojnë në këtë drejtim.

Visar Ymeri - Kërkoi që projektligjet të jenë më të rregulluara në aspektin gjuhësor dhe në atë të përkthimit. Tha se po kanë probleme të shumta gjatë shqyrtimit, kur po duhet të bëhen amendamente. Shtoi se për këto çështje duhet të gjendet një zgjedhje, që të mos ballafaqohen çdo herë me probleme të natyrës së njëjtë.

Komisioni pas debatit nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe

Kuvendit i parashtrohet këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr .04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

2. Arsytimin me rekomandime e paraqet deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Komisioni pas debatit nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve;*
- 1. Grupi i punës ka këtë përbërje: Myzejene Selmani - raportuese, Lutfi Zharku dhe Biserka Kostiq, anëtarë;*

2. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë shqyrtimit të Projektligjit;
3. Grupi i punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit të hartojë planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe për miratim në Komision.

4. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se është hartuar një draft nga Njësia Mbështetëse dhe se është përcaktuar fushëveprimi i Komisionit. Nëse dikush ka ndonjë sugjerim le të deklarohet tani para se të dërgohet për miratim sipas Rregullores së re të Kuvendit.

Visar Ymeri - Propozoi që të hiqet te paragrafi i dytë fjala “të gjitha”, sepse ka fusha të ekonomisë që i mbulon edhe Komisioni për Buxhet.

Me këtë korrigjim u pajtuan dhe anëtarët e Komisionit.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet fushëveprimi i Komisionit

Të njoftohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore i Kuvendit të Kosovës.

5. Të ndryshme

a) Vizita tek agjencitë e pavarura dhe rregullative që i raportojnë Komisionit

Kryetari – Njoftoi deputetët se do të fillohet me aktivitetet mbikëqyrëse tek agjencitë e pavarura dhe rregullative që i raportojnë Komisionit. Si agjenci apo autoritet, së pari do të vizitohet Komisioni Kosovar i Konkurrencës.

b) Njoftimi për vizitën në Republikën e Shqipërisë

Kryetari – Njoftoi deputetët në pika të shkurtra për vizitën e një delegacioni në Republikën e Shqipërisë nga data 24 - 26 tetor 2011. Për këtë tha se do të kemi një pikë të veçantë të rendit të ditës, pasi Njësia Mbështetëse ta përgatitë informatën.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit